

Akt -themelimi

Sot me daten _____, ditën e _____ të vitit 1996, une i quajtura Basri rruka, i biri i Farudinit, lindur me 3.10.1951 në Kukës dhe banuese në Tiranë me adresë Rruga Durrësit Nr.162, vendosa të krijoj me kapitalin tim një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëria do të mbaje si emërte saj "Auto-Star Albania" (A.S.A) SH.P.K. Kapitali në natyrë të shoqërisë "Auto-Star Albania" (A.S.A) SH.P.K. përbehet nga pasuritë e mëposhtme, të cilat janë në pronësi të vetme të Z.Basri Rruka:

-një tokë me sipërfaqe 21238 m², që ndodhet në zonën Nallban, Komuna e Kasharit me vlerë 609.232 USD, nga të cilat 600.000 dollarë është vlera e tokës dhe 9232 USD është vlera e punimeve që janë bërë mbi këtë tokë.

-një dyqan që ndodhet në Rr."Irfan Tomini", Pall 24, Nr 2/38 si dhe trualli para tij që vlerësohet në 65.000 USD.

-një autoveturë BENZ 250 D me vlerë 17.538 USD.

-një kamion DAF me vlerë 76.236 USD.

Kapitali në natyrë të përcaktuar me siper është vlerësuar me ekspertë kompetentë, vlerësim i cili është pranuar nga pronari Basri Rruka. Nga vlerësimet e mësipërme del se kapitali në të holla i kësaj shoqërie është 1.208.000 USD.

Shoqëria, qendren e saj si person juridik do ta ketë me adresë, Rruga. "Punetoret e Rilindjes" Nr.2, Tiranë.

Objekti i veprimtarisë ekonomike të shoqërisë është eksport-importin e autoveturave, të kamioneve, të transportierëve të pjesëve të këmbimit për të gjitha llojet e automjeteve, si dhe tregëtimin e tyre me shumicë dhe me pakicë, servis për autoveturë, kamione dhe transportierë.

Në fillim të aktivitetit të shoqërisë si administrator i saj do të veproj vetë. Me vonë dhe kurdoherë me miratimin tim mund të vendos administrator të shoqërisë një person tjetër.

Do të mbaj përgjegjësi ligjore si pronar dhe ortak i vetëm të shoqërisë për të gjitha detyrat që mund të shkaktohen nga veprimtaria e kësaj shoqërie.

ORTAK I VETEM

BASRI RRUKA



S T A T U T I

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "Auto-Star ALBANIA" (A.S.A) SH.P.K

K R E U I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

N E N I 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Auto-Star ALBANIA" (A.S.A) SH.P.K themelohet ne perputhje me ligjin Nr 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligji Nr 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrimin ne regjistrin tregtar".

Kjo shoqeri krijohet me ortak te vetem Basri Rruka.

Shoqeria ka seline e saj ne Rr. "Punetoret e Rilindjes", Nr. 2, Tirane.

Shoqeria "Auto-Star ALBANIA" (A.S.A) SH.P.K ka te drejte te cele filiale,dege dhe perfagesi ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj, dhe vecanerisht drejtori te vecanta per drejtimin e aktivitetit te shoqerise,ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ate te vendeve te tjera ku ato do te hapen.

Administrator i kesaj shoqerie eshte Basri Rruka.

N E N I 2

Shoqeria "Auto-Star ALBANIA" (A.S.A) SH.P.K e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Shoqeria "Auto-Star ALBANIA"(A.S.A) SH.P.K eshte person juridik.Ajo fiton te drejten e personit juridik nga data e regjistrimit ne Gjykate.

N E N I 3

Shoqeria "Auto-Star ALBANIA" (A.S.A) SH.P.K krijohet per te ushtruar veprimtarine e saj per nje kohezgjatje mbi vjetesh.

Shoqeria "Auto-Star ALBANIA" (A.S.A) SH.P.K mund te zgjate afatin e veprimtarise se saj ose te mbylle aktivitetin e saj para ketij afati,sipas dispozitave qe percaktohen ne kete statut dhe sipas kriterëve qe percaktohen nga legjislacioni ne fuqi.

N E N I 4

Shoqeria "Auto-Star Albania" (A.S.A) SH.P.K per detyrimet qe do te lindin gjate aktivitetit te saj me te tretet ,pergjigjet vetem me pasurine e saj.

Ortaku i vetem i kesaj shoqerie nuk pergjigjet per detyrimet e kesaj shoqerie me pasurine e tij qe nuk eshte futur ne kapitalin e kesaj shoqerie.

Pjesemarrja ne kete shoqeri nuk e pengon ortakun e vetem te kete pavaresi ligjore,organizative dhe te drejta pronesie jashte kesaj shoqerie.

(b) *ms*



OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

N E N I 5

Shoqeria "Auto-Star ALBANIA"(A.S.A) SH.P.K do te kete si objekt:
eksport-importin e autoveturave, te kamioneve, te transportiereve te pjeseve te kembimit per te gjitha llojet e automjeteve, si dhe tregetimin e tyre me shumice dhe me pakice, servis per autovetura, kamione dhe transportiere.

Shoqeria eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se saj. Shoqeria mund te bleje dhe te shfrytetoje te drejta te tjera materiale, perfshire te drejten per te ofruar pasurite e saj dhe per te marre kredi bankare.

K R E U II

MARREDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE.

KAPITALI THEMELTAR

N E N I 6

Kapitali ne natyre i shoqerise "Auto-Star ALBANIA" (A.S.A) SH.P.K perbehet nga pasurite e meposhtme, te cilat jane ne pronesi te vetme te z.Basri Rruka:

- nje toke me siperfaqe 21238 m2, qe ndodhet ne zonen Nallban, Komuna e Kasharit me vlere 609.232 USD, nga te cilat 600.000 dollare eshte vlere e tokes dhe 9232 USD eshte vlere e punimeve qe jane bere mbi kete toke.

- nje dyqan qe ndodhet ne Rr."Punetoret e Rilindjes" Nr 2 dhe qe sipas aktit te ekspertimit eshte vleresuar me shumen 440.000 USD.

- nje dyqan qe ndodhet ne Rr "Irfan Tomini", Pall 24, Nr 2/38 si dhe trualli para tij qe vleresohet ne 65.000 USD.

- nje autoveture BENZ 250 D me vlere 17.538 USD.

- nje kamion DAF me vlere 76.236 USD.

Kapitali ne natyre i percaktuar me siper eshte caktuar me eksperte kompetente, vleresim i cili eshte pranuar nga pronari Basri Rruka. Nga vleresimet e mesiperme del se kapitali ne te holla i kesaj shoqerie eshte 1.208.000 USD.

Ky kapital themeltar zoterohet nga ortaku i vetem.

Kapitali themeltar ose pjese te caktuara te tij jane te transferueshme perkundrejt personave te trete. Transferimi i kapitalit ne favor te nje personi te trete behet gjithmone me akt noterial.

Te gjitha veprimet e shoqerise me kapitalin themeltar behen me miratimin e ortakut te vetem. Vleresimi i kapitalit themeltar ne natyre behet nga ortaku ne nje marreveshje te vecante ose nga nje ekspert i caktuar nga vete ai.



N E N I 7

Kapitali themeltar dhe transferimet e tij mbahen ne nje regjister te vecante.

N E N I 8

Fitimi neto i realizuar nga aktiviteti i shoqerise do te disponohet nga ortakut i vetem.

N E N I 9

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te leverdise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancin e saj. Bilanci i aktivitetit te shoqerise duhet te perfundoje brenda muajit Mars te vitit pasardhes. Bilanci i aktivitetit financiar mund te behet nga vete ortakut ose nga eksperte te caktuar prej tij.

N E N I 10

Shoqeria krijon fondet e saj per zhvillimin e zgjerimin e aktivitetit te saj, ne perputhje me rregullat ne fuqi.

Perberja e fondeve, burimet financiare te tyre, caktohen nga ortakut.

N E N I 11

Shoqeria i disponon plotesisht mjetet e saj financiare.

K R E U III

TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKUT

N E N I 12

Ortakut i vetem ka te drejta kryesore te cilat ushtrohen nepermjet vendimeve te marra:

-Te marre pjese ne administrimin e veprimtarive ekonomiko-tregtare te shoqerise ne perputhje me statutin.

-Te kerkoje dhe t'i jepen te dhena qe kane te bejne me gjendjen dhe veprimtarine e shoqerise si dhe te gjitha dokumentet e perpunuara nga shoqeria (bilanci, libra llogarie)

-Te mbylle shoqerine kur cmohet e arsyeshme prej tij.

N E N I 13

Ortakut i vetem ka keto detyra kryesore:

-Te zbatoje kriteret e caktuara nga ligji ne fuqi, per punetoret dhe nepunesit qe punesohen ne shoqeri.

K R E U I V

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I SHOQERISE

N E N I 14

Administratori i shoqerise ka te gjitha kompetencat qe te veproje ne emer dhe per llogari te shoqerise ne marredhenie me personat e trete.

Shoqeria merr persiper te gjitha pasojat qe mund te vijne nga veprimet e administratorit.

N E N I 15

Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ose ndaj personave te trete, kur gjate veprimeve te tyre shkelin ligjin, statutin ose per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

N E N I 16

Marredheniet e punes me punetoret qe do te punesohen prane shoqerise "Auto-Star ALBANIA" (A.S.A) SH.P.K regullohen me kontrate individuale, qe do te lidhet me secilin prej tyre.

K R E U V

MBYLLJA E AKTIVITETIT TE SHOQERISE

N E N I 17

Veprimtaria e shoqerise pushon me mbarimin e afatit te percaktuar ne statut, ne qofte se ortaku i vetem me vullnetin e tij te lire nuk e zgjat kete afat.

Ajo mund te pushoje veprimtarine e saj edhe para afatit te parashikuar ne statut kur per kete merr vendim ortaku i vetem.

Veprimtaria e shoqerise pushon edhe ne ato raste kur ortaku vendos shnderrimin e shoqerise nga SH.P.K ne nje lloj tjeter shoqerie.

N E N I 18

Kur shoqeria likuidohet plotesisht ortaku i vetem krijon Komisionin e Likuidimit, i cili paraqet bilancin e likuidimit.

Pasuria e shoqerise qe ngelet pas shlyerjes se detyrimeve te saj i kalon i gjithi ortakut te vetem.

Pasuria qe eshte futur ne shoqeri me te drejta shfrytezimi i kthehet pronarit te saj.

O R T A K U I V E T E M

Tirane, me _____.

Basri Rruka

